



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . ____ . _____

PROCESVERBAL

**Takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të
Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile**

Më datë 4 prill 2018, ora 10:00, pranë ambjenteve të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) u zhvillua një takim pune me anëtarë të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), përfaqësues nga AMSHC dhe ekspertin e Asistencës Teknike.

Në takim marrin pjesë:

Anëtarë të shoqërisë civile të KKSHC-së:

1. Znj. Iris Luarasi
2. Z. Ali Coka
3. Znj. Zana Vokopola
4. Z. Vladimir Thanò
5. Znj. Emanuela Zaimi
6. Znj. Afërdita Seiti

Përfaqësues nga AMSHC:

1. Znj. Ina Gjini
2. Znj. Leonida Hasa
3. Z. Andi Luga

Ekipi i Asistencës Teknike:

1. Z. Max Fras

Z. Max shtron pikat e axhendës së takimit:

- Raporti vjetor i KKShC-së dhe modelet e raportimit
- Planin afatgjatë të punës së KKShC-së 2018-2020
(në bazë të planit të punës për 2018, tashmë të miratuar)
- Aktet nënligjore të kodit të sjelljes, të anëtarëve të organizatave të shoqërisë civile
- Përditësimet e buxhetit të KKShC-së
- Politikat e rimbursimit të udhëtimit të KKShC-së

Të gjithë anëtarët e pranishëm të shoqërisë civile diskutan rreth faktit përse në mbledhjen e fundit të mbajtur në ambjentet e kryeministrisë nuk u mbajt nga ana e Asistencës teknike të BE pika për ecurinë e procesit të Udhërrëfyesit (*Road Map*). Z. Max shprehet se për këtë çështje mund të pyetet kryetarja e KKSHC-së, znj. Manastirliu e cila drejtoi këtë takim.

Gjithashtu përpara u diskutua edhe për një letër të mundshme që mund t'i drejtohet znj. Manastirliu, ku të shtrohen dy çështje të rëndësishme sipas anëtarëve të pranishëm në mbledhje:

1. Këshilli ka një sasi gjetjesh për Udhërrëfyesin (*Road Map*) dhe përse nuk u bë prezent
2. Si t'i japim rëndësinë e duhur këtyre takimeve duke sjellë përfaqësuesit e lartë nga Ministrinë jo vetëm specialisët e thjeshtë.

Znj. Seiti u shpreh se anëtarët e Këshillit përfaqësues të shoqërisë civile kanë të njëjtin status dhe përgjegjësi të njëjta me Zëvendësministrat, kështu që ajo propozon që letrën me çështjet e mësipërme t'u dërgohet jo vetëm Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por të gjithë Ministrive.

Z. Thanu shton se Këshilli duhet të fuqizohet duke ushtruar presion. Ai gjithashtu thote se mund të bëjmë një takim tjetër për të ngritur këto çështje.

Znj. Vokopola thotë se në këtë fazë që janë është më mirë të drejtojnë një letër. Letra është dokument zyrtar që mbetet.

Znj. Zaimi thotë se është dakort me propozimin e Zanës për t'i drejtuar një letër Ministres dhe pse akoma nuk është marrë asnjë përgjigje edhe për letrën e parë që i është dërguar për fondet publike.

Z. Coka bie dakort me çfarë u tha mësipër nga kolegët, ai shton se është e rëndësishme komunikimi me Zëvendësministrat, të cilët duhet t'i njohim nga afër. Më pas ai largohet nga mbledhja për shkak të një impenjimi tjetër.

Të gjithë dakort për të çuar letër para datës 13 prill 2018, të cilën do ta dërgojë Blendi.

Pika e dytë e Axhendës, duhet të prezantohej nga z. Dibra, i cili nuk kishte mundësi të vinte në takim. Plani për vitin 2018 është hartuar, ai do të përdoret si plan afatgjatë për 2018-2020.

Në pikën e tretë diskutohet për kodin e sjelljes. Z. Max thotë se kodi i sjelljes duhet të vijë si rezultat i punës së vetë Këshillit, megjithatë ai do të dërgojë një skicë të kodit etik me email.

Gjithashtu anëtarët e pranishëm duke diskutuar për çështjen e komunikimit të gjithë ngritën shqetësimin e komunikimit të jashtëm, pra me palët e treta (me publikun, grupet e interesit, mediat) duket sikur ky komunikim aktualisht bëhet vetëm nëpërmjet minutave që dalin nga mbledhjet e KKSHC-së, të cilat publikohen në faqen e AMShC-së.

Znj. Zaimi dhe z. Thanu shtrojnë mendimin se këto procesverbale/minuta ose mendime që dalin nga takimet dhe mbledhjet t'i publikojnë/shpërndajnë edhe në faqet personale të Facebook të secilit anëtar për të patur një vizibilitet më të madh.

Znj. Vokopola sugjeron që Këshilli të ketë një strategji komunikimi si brenda ashtu edhe jashtë tij me Qeverinë dhe me organizatat e tjera të shoqërisë civile.

Znj. Seiti shton se komunikimi i brendshëm midis 13 anëtarëve të Këshillit është shumë i rëndësishëm.

Anëtarët e pranishëm thonë se në mbledhjen e fundit të KKSHC-së është propozuar një projekt ligj i cili nuk ishte i konsultuar nga të gjithë anëtarët e Këshillit. Kjo nuk duhet të ndodhë, se në radhë të parë anëtarët përfaqësues të shoqërisë civile nuk duhet të draftojnë ligje dhe për më tepër nuk mund t'i paraqesin ato si propozime të pakëshilluara brenda Këshillit.

Z. Max thotë se Asistenca Teknike nuk e ka pjesë të misionit të saj hartimin e një kodi etik apo hartimin e një strategjie apo plani komunikimi, por Asistenca Teknike mund të ndihmojë në verifikimin e disa fushave për t'u trajtuar. Ajo që ka për detyrë komisioni i Asistencës teknike është plani i komunikimit në lidhje me Udhërrëfyesin (Road Map). Anëtarët e shoqërisë civile shton ai janë të zgjedhur, në këtë kuptim janë një parlament i vogël, sepse kanë zgjedhësit e vet. Përsa i përket komunikimit mes njeri-tjetrit anëtarët janë të pavarur, por kur flitet në emër të Këshillit situata ndryshon.

Z. Thanu gjithashtu kërkon nga AMShC që dokumentet e brendshme për funksionimin e Këshillit të jenë online, p. sh aktivitetet, rregullorja, raporti të jenë në një dosje (*folder*) të ndara nga procesverbalet e takimeve.

Për pikën katërt kërkohet pjesëmarrja e znj. Leonida Hasa, Përgjegjëse e Sektorit - Monitorimi Financiar i Granteve në AMShC, e cila do të përgjigjet për pjesën e buxhetit.

Znj. Hasa i përgjigjet dy pyetje të ngritura nga z. Max:

1. A është e vërtetë së buxheti i AMShC-së për Këshillin është rritur nga 600,000 Lekë në 1,000,000 Lekë? Ajo përgjigjet se buxheti nuk ka ndryshuar.
2. Gjithashtu ajo sqaron çështjen e dytë, që ka të bëjë me një akt nënligjor që saktëson shpenzimet që AMShC-ja do t'i mbulojë Këshillit si dhe mënyrën si do të mbulohen këto shpenzime.

Përsa i përket çështjes së TVSH-së, znj. Vokopola shprehet se ligji ekziston por asnjë shoqatë nuk rimbursohet nga Zyra e Tatim Taksave. Ajo propozon dërgimin e një letre për këtë çështje. Vetë BE e ka kërkuar që nëqoftëse nuk rimbursohet TVSH-ja nuk do të ketë më asnjë projekt në Shqipëri.

Znj. Seiti shton se në letrën që do të dërgohet të specifikohet se të gjitha projektet duhen rimbursuar (jo vetëm projektet IPA ashtu siç është parashikuar në letër.)

Z. Max thotë se kjo letër tashmë i është dërguar Delegacionit të BE-së dhe po pritët që ata ta konsultojnë dhe të kthejnë përgjigje.

Të gjithë anëtarët bien dakort se më pas kjo letër duhet publikuar në faqen zyrtare online të AMShC-së dhe çdo anëtar gjithashtu mund ta shpërndajë (*share*) në profilin e tij në rrjetet sociale.

Z. Max gjithashtu shton se Marian Nikolov (eksperti i BE për taksat) do të vijë për 10 (dhjetë) ditë dhe do të zhvillojë një takim më Këshillin. Përsa u përket takimeve rajonale ai thotë do t'i përcaktojmë nga fundi i këtij muaji kontributet e mbledhura nga Asistenca Teknike për çështjet e TVSH-së.

Gjithashtu ai sqaron dy takimet e ardhshme, që janë:

- Datë 12 prill 2018, është tryezë e rumbullakët për kontributin e shoqërisë civile për integrimin evropian.
- Datë 13 prill 2018, është takim me Asistencën Teknike.

Ai sqaron se nuk mund të bëhen takimet në të njëjtën ditë ashtu siç kërkuan anëtarët.

Takimi i datës 12 prill është parashikuar i plotë, me drake, kafe, dhe zgjat deri në orën 15.00 dhe do të ketë pjesëmarrës nga Ministria, Delegacioni i BE dhe është e pamundur të ndërrohet axhenda.

Ekspertet nga vendet e rajonit do të flasin për eksperiencat e tyre, si funksionojnë gjërat në Serbi, Mal të Zi dhe Kroaci dha pastaj Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të shprehet se si e

shih rolin e Shoqërisë Civile dhe si e shih procesin e integritit. Pas drekës do të formohen tre grupe pune sipas fushave prioritare.

Znj. Vokopola dhe z. Thanu shprehen se koha e zhvillimit të kësaj tryeze është e gabuar, sepse me datë 11 prill 2017 lançohet Raport Progresi i Delegacionit, në mënyrë që Shoqëria Civile të kishte parë çfare thotë Raporti në pjesën e rekomandimeve dhe pastaj të zhvillohej tryeza e rrumbullakët në mënyrë që anëtarët të ishin sa më aktiv.

Z. Max sqaron se në tryezën e rrumbullakët anëtarët e shoqërisë civile janë të ftuar si përfaqësues të shoqërisë civile për të dëgjuar eksperiencat e eksperteve nga vendet e rajonit dhe më pas në grupet e punës është parashikuar që anëtarët përfaqësues të shoqërisë civile të shikojnë si punohet nga ana teknike, sepse pritet që Këshilli të jetë i lidhur me procesin e integritit.

Znj. Vokopola pyet: “Kur flitet për kontributet e shoqërisë civile, i referohet atyre aktuale?”

Z. Max i përgjigjet se për arritjet dhe kontributet e Shoqërisë civile do të shprehet Ministria jo anëtarët.

Znj. Luarasi shprehet se duhet t’i jepet një rol dhe një zë shoqërisë civile në procesin e hapjes së negociatave.

Znj. Zaimi shprehet për qëndrimin që duhet të mbajnë anëtarët e shoqërisë civile për disa “çështje të nxehta” të aktualitetit si p.sh çështja e nxjerrjes nga skema e ndihmës ekonomike e disa grupeve dhe gjithashtu çështja e taksës/tarifës në rrugën e Kombit. Ajo pyet nëse duhet të mbajnë një qëndrim për këto çështje si anëtarë të KKShC-së.

Znj. Luarasi shprehet se këto kauza janë të drejta për t’u ngritur. Ajo thotë se problemi në Shqipëri është se këto kauza të drejta politizohen.

Ajo shprehet: “Në emër të Këshillit ne mund të bëjmë një Deklaratë për Shtyp (*Press Release*) për këto çështje, për të mbajtur një qëndrim duke mbështetur në këtë rast qytetarët e Kuksit dhe duke ftuar Qeverinë që të negociojë taksën/tarifën.”

Të gjithë anëtarët bien dakort që është e rëndësishme që anëtarët përfaqësues të shoqërisë civile të reagojnë ndaj këtyre tematikave dhe të fuqizojnë Këshillin.

Znj. Seiti shprehet se duhet reaguuar që në momentin e parë kur ndryshohet një ligj nga Qeveria, pra duhet reaguuar në kohën e duhur.

Në përfundim të takimit z. Max propozon që takimin e datës 13 prill të bëhet mbasditen e datës 12 prill 2018, pas përfundimit të punimeve të tryezës së rrumbullakët.

12:00 – Takimi mbyllet.

SHTOJCA 1:

Raport Hije i Anëtarëve të Shoqërisë Civile për vitin 2017

SHTOJCA 2:

(Për përdorim të brendshëm të KKShC)

CSO – VAT and general taxation issues

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile

Raport Hije i Anëtarëve të Shoqërisë Civile për vitin 2017

Pasqyra e lëndës

Pjesa 1: Aktivitetet e Këshillit Kombëtar për mbështetjen e Shoqërisë Civile	22
1.1. Mbledhjet e Këshillit Kombëtar	22
1.2. Takimet e anëtarëve të OShC-ve me mbështetjen e ekipit të Asistencës Teknike ..	22
1.3. Caktimi i Zëvendëskryetarit të Këshillit në nëntor 2017 dhe hartimi i akteve nënligjore	22
1.4. Mbështetja për zhvillimin e debatit publik sa i përket shqyrtimit të udhërrëfyesit	22
1.5. Zhvillimi i marrëdhënieve me Agjencinë Shtetërore si Sekretariati i Këshillit	22
Pjesa 2: Raporti për zbatimin e Udhërrëfyesit	23
2.1. Nëntë fushat prioritare në Udhërrëfyesin e 2015-ës:	23
2.2. Përmbledhje e raportit për zbatimin e Udhërrëfyesit	24
1. MJEDISI KOMBËTAR I POLITIKAVE STRATEGJIKE PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE	25
2. INSTITUCIONET QË MBËSHTESIN BASHKËPUNIMIN QEVERI-OSHC	26
POLITIKËBËRJES	29
Shtojca 1 Statusi i masave të vitit 2015 sipas vëzhgimeve të anëtarëve të OShC-ve në Këshill	41

Ky raport mbështetet kryesisht në Udhërrëfyesin e vitit 2015 për politikat e qeverisë shqiptare për një mjedis më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile. Në Udhërrëfyes renditen të gjitha prioritetet kryesore që kërkojnë marrjen e disa masave nga qeveria e Shqipërisë për krijimin e një mjedis (ligjor, fiskal dhe bashkëpunues midis shoqërisë civile dhe qeverisë) që do t'i jepte mundësi shoqërisë civile në Shqipëri të lulëzonte e të bëhej me efizente në punën e saj.

Në kapitullin 1 të raportit jepet një përmbledhje e shkurtër e aktiviteteve të realizuara në vitin 2017 me KKShC-në, kryesisht nga anëtarët e këtij këshilli që vijnë nga shoqëria civile.

Pjesa e dytë e këtij raporti hije i përkushtohet zbatimit të Udhërrëfyesit. Ai mbështetet në kontributet e dhëna nga anëtarët e OShC-ve të KKShC-së, zonat që ata mbulojnë dhe nga organizata të tjera të shoqërisë civile gjatë takimeve formale dhe joformale mbajtur në vitin 2017, studimeve dhe literaturës ekzistuese, si dhe mbi rezultatet e konsultimeve për Udhërrëfyesin zhvilluar në të gjithë Shqipërinë në dhjetor 2017 dhe online në periudhën dhjetor 2017 – janar 2018.

Kjo pjesë e dytë e raportit shqyrton secilën nga masat e Udhërrëfyesit në dy mënyra: kategorizimit dhe përshkrimit të progresit të arritur për secilën prej tyre.

Kategorizimi i ndan masat në masa të zbatuara plotësisht, masa në proces zbatimi, masa që nuk janë zbatuar fare dhe masa për të cilat nuk ka asnjë lloj informacioni.

Në kategorinë e 'masave të zbatuara plotësisht' futen ato masa për të cilat përfaqësuesit e OShC-ve mendojnë se masa është zbatuar plotësisht dhe në përputhje me angazhimet e qeverisë si përsa i përket procesit (sipas ligjit të KKShC-së), ashtu edhe rezultateve të tyre.

'Masat në proces zbatimi/të zbatuara pjesërisht' përfshijnë masat që nuk janë zbatuar ende plotësisht, duke pasur parasysh procesin ose rezultatet e arritura deri tani.

'Masat e pazbatuara' përfshijnë ato masa për të cilat ose nuk është ndërmarrë asnjë hap ose procesi dhe/ose rezultatet nuk kanë qenë të kënaqshme.

'Masa për të cilat nuk ka informacion' përfshijnë ato masa, për të cilat ose nuk ka pasur informacion ose ky informacion ka qenë i paaksesueshëm për anëtarët e shoqërisë civile të KKShC-së.

Pasi bëhet kategorizimi, jepet një përshkrim i kategorive mbi bazën e kontributeve të renditura më sipër: takimet e anëtarëve të shoqërisë civile të KKShC-së, takimet në zona të ndryshme dhe me OShC të tjera dhe konsultimet për Udhërrëfyesin.

Pjesa 1: Aktivitetet e Këshillit Kombëtar për mbështetjen e Shoqërisë Civile

1.1. Mbledhjet e Këshillit Kombëtar

Janë zhvilluar dy mbledhje në vitin 2017 – një në shkurt dhe një në dhjetor. Procesverbalet e këtyre mbledhjeve janë mbajtur nga Agjencia Shtetërore për mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe janë publikuar në faqen e saj zyrtare.

1.2. Takimet e anëtarëve të OShC-ve me mbështetjen e ekipit të Asistencës Teknike

Më shumë se 4 takime janë zhvilluar me ekipin e Asistencës Teknike për të diskutuar metodat e punës, Udhërrëfyesin dhe çështje të tjera. Të gjitha procesverbalet janë të disponueshme në Agjencinë Shtetërore të Shoqërisë Civile.

1.3. Zgjedhja i Zëvendëskryetarit të Këshillit në nëntor 2017 dhe hartimi i akteve nënligjore

Blendi Dibra u zgjodh Zëvendëskryetar nga anëtarët e shoqërisë civile të KKShC-së në muajin nëntor dhe u konfirmua në takimin e KKShC-së në dhjetor 2017.

1.4. Mbështetja për zhvillimin e debatit publik sa i përket shqyrtimit të udhërrëfyesit

Anëtarët e shoqërisë civile të KKShC-së morën pjesë aktivisht në zhvillimin e katër debateve publike mbi Udhërrëfyesin në Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Korçë në dhjetor 2016

1.5 Zhvillimi i marrëdhënieve me Agjencinë Shtetërore si Sekretariati i Këshillit

Muajt e fundit të 2017-ës, Agjencia mori më shumë përsipër rolin e saj si Sekretariati i Këshillit. Që prej atëherë, takimet e anëtarëve të shoqërisë civile të KKShC-së mbahen në agjenci dhe ajo po punon për hartimin e buxhetit për vitin 2018 për të mbështetur planin e punës së Këshillit.

Pjesa 2: Raporti për zbatimin e Udhërrëfyesit

2.1. Nëntë fushat prioritare në Udhërrëfyesin e 2015-ës:

1. Mjedisi kombëtar i politikave strategjike për zhvillimin e shoqërisë civile
2. Institucionet që mbështesin bashkëpunimin qeveri-OShC
3. Përfshirja e OShC-vë në procesin e politikëbërjes
4. Kuadri i Financimeve Publike për programet e OShC-ve
5. Kuadri legjislativ për regjistrimin dhe punën e OShC-ve
6. Raportimi/kontabiliteti financiar dhe trajtimi tatimor për OShC-të
7. Mbledhja e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile
8. Zhvillimi i vullnetarizmit
9. Kontributi i OShC-ve në procesin e anëtarësimit në BE

2.2 Përmbledhje e raportit për zbatimin e Udhërrëfyesit

Gjithsej: 9 prioritete të Udhërrëfyesit - 53 masa

Progresi i arritur deri në shkurt 2018:

4 masa të zbatuara

6 masa në proces zbatimi

41 masa të pazbatuara

2 masa për të cilat nuk ka informacion

Përmbledhja e masave mund të gjenet në Shtojcën

1

1. MJEDISI KOMBËTAR I POLITIKAVE STRATEGJIKE PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

Nuk është arritur progres dhe ka ende pengesa të konsiderueshme.

- 1.1. Përgatitja Strategjisë Kombëtare për krijimin e mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri deri në 2020-ën, si edhe i Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë, me indikatorë të matshëm, me vlerësim konkret efektesh financiare dhe me procedurë të qartë raportimi, monitorimi dhe vlerësimi për të gjitha masat

Statusi: e pazbatuar

Nuk është hartuar asnjë Strategji Kombëtare. OShC-të nuk janë përfshirë në asnjë konsultim për hartimin e një strategjie të tillë. Nuk ka asnjë Plan Veprimi.

- 1.2. mundësimi i pjesëmarrjes së OSHC-ve në të gjitha fazat e përgatitjes së Strategjisë dhe Planit të Veprimit, si edhe zhvillimi i një procesi konsultimi gjithëpërfshirës dhe të plotë me palët e interesuara për draftin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit

Statusi: e pazbatuar

Nuk është hartuar asnjë Strategji dhe asnjë Plan Veprimi (shih 1.1.), kështu që asnjë OShC ë nuk është përfshirë në ndonjë proces të tillë.

- 1.3. përgatitja e raportit mbi rezultatet e konsultimeve publike për draftin e Strategjisë/Planit Kombëtar dhe qarkullimi i gjerë i tij, para dërgimit të draftit për procedurë miratimi

Statusi: e pazbatuar

Nuk është hartuar asnjë Strategji dhe asnjë Plan Veprimi (shih 1.1.), kështu që nuk është organizuar asnjë konsultim publik.

- 1.4. ngritja, pas miratimit të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit, e një sistemi të hapur dhe transparent për gjurmimin e progresit të bërë në zbatimin e të gjitha masave përmes një portali ueb, ku hidhet i gjithë informacioni i përditësuar mbi zbatimin e Strategjisë dhe të Planit të Veprimit

Statusi: e pazbatuar

Nuk është hartuar asnjë Strategji dhe asnjë Plan Veprimi (shih 1.1.), kështu që nuk është krijuar asnjë sistem gjurmimi – ky raport përbën një përpjekje për adresimin e kësaj mangësie.

1.5. kryerja e vlerësimit të jashtëm të zbatimit të Planit të Veprimit

Statusi: e pazbatuar

Nuk është hartuar asnjë Strategji dhe asnjë Plan Veprimi (shih 1.1.), kështu që nuk është hartuar asnjë sistem vlerësimi – ky raport është, gjithashtu, një përpjekje për adresimin edhe të kësaj mangësie.

2. INSTITUCIONET QË MBËSHTESIN BASHKËPUNIMIN QEVERI-OSHC

Krijimi i KKShC-së e ka përmirësuar kuadrin e përgjithshëm të bashkëpunimit qeveri-OSHC që prej hartimit të Udhërrëfyesit, por problemet me zbatimin dhe koordinimin përbëjnë pengesa të konsiderueshme.

2.1. Miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave për ngritjen e Këshillit Kombëtar për zhvillimin e Shoqërisë Civile, si organ këshillimor ndërsektorial i Qeverisë, ku marrin pjesë përfaqësues të ministrive dhe agjencive shtetërore përgjegjëse për fushat kryesore që prekin OSHC-të, si edhe përfaqësues të OSHC-ve të përzgjedhur mbi bazën e kriterëve dhe procedurave të parashikuara në këtë Vendim.

Statusi: në proces zbatimi

Megjithëse ligji i KKShC-së u miratua më 2015-ën, Këshilli u mblodh zyrtarisht vetëm në mars 2017 dhe asnjë takim nuk u mbajt që atëherë deri në dhjetor 2017. Reforma e vazhdueshme e administratës publike e bën shumë të vështirë funksionimin e Këshillit, pasi mbetet pa anëtarësi të plotë – nuk janë emëruar anëtarët e qeverisë së Këshillit nga disa ministri.

2.2. organizimi i procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të OSHC-ve në Këshill, pas një ftese publike dhe duke respektuar parimet e transparencës dhe gjithëpërfshirjes.

Statusi: në proces zbatimi

Zgjedhjet e para ishin larg të qenit transparente dhe gjithëpërfshirëse dhe duhet të përsëriteshin. Zgjedhjet e përsëritura prodhuan disa rezultate – anëtarët janë zgjedhur, por sistemi mbetet për t'u testuar në rizgjedhjen e anëtarëve aktualë.

2.3. garantimi i mbështetjes efiçente administrative dhe me ekspertizë të Këshillit (përfshi përgatitjen e plotë të materialeve për të gjitha seancat dhe ndjekjen e duhur të të gjitha konkluzioneve të Këshillit), duke akorduar numrin e duhur të nëpunësve kompetentë në Sektorin brenda Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj në Kryeministri, që duhet të shërbejë si Sekretariat i Këshillit.

Statusi: në proces zbatimi

AMShC-ja mbetet e paplotë me staf dhe vendet bosh që lidhen me Këshillin janë ende të paplotësuara. Këshilli nuk ka pasur buxhet në vitin 2017 dhe anëtarëve të tij nuk u është bërë asnjë rimbursim udhëtimi.

2.4. përgatitja e një strategjie afatgjatë të AMSHC-së për arritjen e objektivave kryesorë të parashikuar në Statutin e saj.

Statusi: në proces zbatimi

Agjencia e ka një strategji, por ajo nuk është në përputhje me prioritetet dhe planin e punës së Këshillit dhe mbetet për t'u zbatuar.

2.5. hartimi i planit të komunikimit, informimit dhe angazhimit që t'i përgjigjet kërkesave në rritje për informim dhe mbështetje nga OSHC-të vendore.

Statusi: e pazbatuar

Agjencia nuk ka ndonjë plan komunikimi/informimi.

2.6. organizimi i asistencës teknike të BE-së për AMSHC-në që të ndërtojë kapacitetet për menaxhimin e fondeve të BE-së për shoqërinë civile në të ardhmen

Statusi: nuk ka informacion

Anëtarët e OSHC-ve nuk kanë ndonjë informacion lidhur me këtë.

2.7. ndryshimi i rregullores për strukturën organizative të Kryeministrisë për të mundësuar ngritjen e një Njësie për koordinimin e politikave të shoqërisë civile brenda Departamentit të Zhvillimit të Programimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj.

Statusi: në proces zbatimi

Drejtoria e Politikave dhe Prioriteteve për Zhvillim po ndjek Programin e Shoqërisë Civile. Një koordinator ia kushton një pjesë të kohës së saj çështjeve të OSHC-ve.

2.8. sigurimi i burimeve financiare dhe njerëzore të mjaftueshme për punën efektive të Njësisë

Statusi: e pazbatuar

Shih më sipër – çështjet e shoqërisë civile përbëjnë vetëm një pjesë të punës së një anëtari të vetëm në Kryeministri.

2.9. emërimi i personave të kontaktit dhe, sipas nevojës, ngritja e njësive të posaçme për bashkëpunimin me OSHC-të në ministri dhe organe shtetërore të tjera

Statusi: e pazbatuar

Nuk ka të dhëna të konsoliduara për personat e kontaktit dhe jo të gjitha ministrinë i kanë kontaktet për OSHC-të apo për vetëm për personat e kontaktit për konsultimet publike për OSHC-të .

2.10. publikimi i listës së personave të kontaktit me hollësi relevante, në faqet e internetit të të gjitha ministrive/organeve publike

Statusi: e pazbatuar.

Shih më sipër.

2.11. organizimi i takimeve periodike koordinuese me personat e kontaktit (detyrë e mundshme e Njësisë për shoqërinë civile në Kryeministri)

Statusi: e pazbatuar.

Shih më sipër.

3. PËRFSHIRJA OSHC-ve NË PROCESIN E POLITIKËBËRJES

Është arritur deri diku progres në kuadrin e përgjithshëm të politikëbërjes, por ende ka probleme të konsiderueshme me zbatimin dhe ndjekjen e politikave

- a. Miratimi i akteve të nevojshme nënligjore dhe sigurimi i parakushteve institucionale që garantojnë zbatimin efikas të ligjit për njoftimet dhe konsultimet

Statusi: e pazbatuar

OSHC-të nuk lejohen të marrin pjesë në proceset e konsultimit si grup më vete.

- b. krijimi i regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike

Statusi: në proces zbatimi

Faqja e internetit për konsultimet publike ka funksione shumë të kufizuara.

- c. përgatitja e manualit me udhëzime hap pas hapi për nëpunësit civilë mbi zhvillimin e konsultimeve publike efektive.

Statusi: e pazbatuar

Nuk ekziston ndonjë manual dhe sipas komenteve të OSHC-ve, nëpunësit civilë nuk i njohin procedurat efikase të konsultimit publik.

- d. përgatitja e metodologjisë për raportimin vjetor të rezultateve të konsultimeve publike dhe rritja e transparencës së procesit të vendimmarrjes, me informimin e duhur mbi numrin e akteve të miratuara nga organi publik gjatë vitit të caktuar, numrin e rekomandimeve që u kanë shkuar aktorëve, numrin e rekomandimeve dhe komenteve të refuzuara

gjatë procesit të vendimmarrjes dhe numrin e takimeve publike të organizuara.

Statusi: e pazbatuar

Nuk bëhet raportim vjetor për konsultimet publike. OSHC-të nuk kanë akses në procesin e rezultateve të tyre.

- e. dhënia e çmimit kombëtar vjetor për praktikat më të mira në lidhje me transparencën dhe gjithëpërfshirjen e procesit të vendimmarrjes në organet publike

Statusi: e pazbatuar

Nuk është dhënë asnjë çmim.

- f. krijimi i një programi trajnues për nëpunësit civil, i drejtuar nga Shkolla Shqiptare për Administratën Publike, fokusuar në bashkëpunimin Qeveri-shoqëri civile në politikëbërjen publike.

Statusi: nuk ka informacione të detajuara, mendohet se kjo masë është në proces zbatimi

Sipas Kryeministrit, është përgatitur një program trajnimi në lidhje me ligjin për njoftimet publike. Ky trajnim përfshin edhe një pjesë për mënyrën se si duhet punuar me shoqërinë civile.

4. KUADRI I FINANCIMIT PUBLIK PËR PROGRAMET E OSHC-ve

Asnjë progres – OSHC-të mbeten tejte të varura nga financimet e jashtme, ndërkohë që mundësitë vendase të financimit, sidomos ato publike, janë të rralla dhe nuk komunikohen në mënyrë transparente dhe në të gjithë vendin

4.1. ndryshimi i ligjit për organizatat jofitimprurëse me nene të reja për mbështetjen shtetërore të OJF-ve, që siguron bazën ligjore për miratimin e aktive nënligjore (rregullore), për përcaktimin e standardeve, parametrave dhe kriterëve të qarta për alokimin e fondeve publike për programet e OSHC-ve, përfshi kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve sociale si në nivel kombëtar dhe vendor të qeverisjes, por edhe për përcaktimin e bazës për përparimin domethënës në transparencën e procedurave të alokimit të fondeve dhe disponueshmërinë e të dhënave të hollësishme mbi rezultatet e thirrjeve për propozime

Statusi: e pazbatuar

Nuk ka pasur ndonjë ligj të ri apo ndryshime të ligjit ekzistues.

4.2. krijimi i një databaze publike me informacion të detajuar rreth të gjitha granteve nga buxheti i Shtetit për OSHC-të, ku organizatat dhe ministritë/ institucionet publike mund të gjejnë informacion.

Statusi: e pazbatuar

Nuk është krijuar asnjë bazë publike të dhënash.

4.3. përgatitja e raporteve vjetore për financimin e përgjithshëm publik për programet e OSHC-ve me analizë të detajuar të fushave kryesore dhe të përfituesve të granteve, si dhe të dhëna të sakta mbi punën e të gjitha organeve publike që ofrojnë financim për programet e OSHC-ve, në drejtim të respektimit të standardeve, parimeve dhe procedurave të vendosura nga Rregullorja.

Statusi: e pazbatuar

Nuk është hartuar asnjë raport vjetor.

4.4. krijimi i një sistemi të përbashkët informativ mbi financimin publik të OSHC-ve për të mundësuar koordinim dhe shkëmbim informacioni në kohë reale dhe efektiv ndërmjet të gjitha organeve publike që financojnë programet e OSHC-ve.

Statusi: e pazbatuar

Nuk është prezantuar asnjë sistem i përbashkët informacioni.

4.5 Ndryshimi i akteve ligjore ekzistuese ose hartimi i akteve të reja në fushën e prokurimit publik, standardizimit dhe licencimit të shërbimeve sociale, me qëllim mundësimin e kontraktimit efikas të OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve sociale

Statusi: e pazbatuar

Nuk është zbatuar asnjë akt ligjor. Janë në proces hartimi më shumë se 10 akte nënligjore të ligjit për shërbimet sociale.

5. KUADRI LEGJISLATIV PËR REGJISTRIMIN DHE PUNËN E OSHC-ve

Nuk është bërë asnjë ndryshim dhe çështjet e regjistrimit mbeten urgjente dhe të rëndësishme për t'u zgjidhur.

Masat e propozuara:

5.1. ndryshimi i ligjit aktual për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse për të mundësuar decentralizimin e procesit të regjistrimit të OJF-ve

Statusi: e pazbatuar

Nuk është bërë asnjë ndryshim në ligjin aktual për regjistrimin dhe vështirësi të konsiderueshme mbeten po ato për shumicën e OSHC-ve. Përveç kësaj, bankat i kanë rritur kërkesat burokratike për OJQ-të, duke u kërkuar rikonfirmim të anëtarësisë së bordit për çdo verim, gjë së sipas tyre bëhet për të parandaluar mashtrimet.

5.2. përgatitja e udhëzimeve të hollësishme për organet kompetente të regjistrimit në nivel vendor për të siguruar zbatimin e harmonizuar të ligjit

Statusi: e pazbatuar

Shih më sipër.

5.3. hartimi i programit trajnues për organet kompetente (gjykatat) për regjistrimin e OJF-ve

Statusi: e pazbatuar

Shih më sipër.

5.4. krijimi i sistemit të përbashkët informativ elektronik që lidh të gjitha organet e regjistrimit në nivel vendor dhe që mundëson përditësimin automatik të informacionit për të gjitha OJF-të e regjistruara

Statusi: e pazbatuar

Shih më sipër.

6. KONTABILITETI / RAPORTIMI FINANCIAR DHE TRAJTIMI TATIMOR I OSHC-ve

Nuk ka pasur asnjë ndryshim të konsiderueshëm dhe të gjitha çështjet që lidhen me tatimet vazhdojnë të kenë rëndësi të madhe.

Masat e propozuara:

6.1. hartimi i një projektakti të veçantë për operacionet financiare dhe kontabilitetin e OJF-ve që merr parasysh specifikat e menaxhimit të tyre

Statusi: e pazbatuar

Shumica e OSHC-ve trajtohen si biznese dhe shpërfillet legjislacioni aktual (shih ligjin për TVSH-në).

6.2. Debat i hapur publik për të përmirësuar standardin e raportimit financiar për organizatat jofitimprurëse me qëllim mundësimin e një mbledhjeje më cilësore të të dhënave në sektorin jofitimprurës

Statusi: në proces zbatimi

Kanë dalë disa standarde të reja raportimit, por nuk pati as debat publik dhe as iu dha ndonjë informacion sektorit të shoqërisë civile

- 6.3. ndryshimi i legjislacionit fiskal aktual për të njohur donacionet për OSHC-të si shpenzime të zbritshme, me qëllim që të nxitet filantropia individuale dhe të kontribuohet në qëndrueshmërinë e përpjekjeve të shoqërisë civile

Statusi: e pazbatuar

Nuk ekziston asnjë ligj për donacionet private.

- 6.4. Analizimi i ndikimit të kriterëve ligjorë aktualë që detyron çdo OSHC të regjistruar të ketë të paktën një punonjës për të cilin paguhen sigurimet shëndetësore dhe shoqërore.

Statusi: në proces zbatimi

Ligji vazhdon të jetë në fuqi, duke përbërë një barrë të konsiderueshme për OShC-të e vogla dhe të mesme. Aktualisht, po bëhet një studim në kuadrin e AT-së.

- 6.5. krijimi i një databaze qendrore *online* me të gjitha raportet financiare të organizatave jofitimprurëse që mund të bëhen publike, me synimin për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e organizatave jofitimprurëse

Statusi: e pazbatuar

Nuk është krijuar asnjë lloj baze të dhënash.

7. MBLEDHJA DHE DISPONUESHMËRIA E TË DHËNAVE PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

Nuk ka nevojë urgjente për asnjë lloj ndryshimi apo të dhënash për të hartuar politika të bazuara tek faktet/provat

Hapat e propozuar:

7.1. ndryshimi i ligjit aktual për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse që është rregullimi i procedurave për regjistrimin e OJF-ve, si dhe për mirëmbajtjen e regjistrit – kapitulli përkatës i ligjit (veçanërisht Kapitulli III mbi formën dhe përmbajtjen e Regjistrit) duhet të ndryshohet në mënyrë që të lejojë krijimin e regjistrit elektronik.

Statusi: e pazbatuar

Nuk është krijuar regjistri elektronik.

7.2. për të lejuar publikun e interesuar që të ketë akses në të dhënat themelore të OSHC-ve të regjistruara, duhet të krijohet një databazë e aksesueshme publike që do të përditësohet rregullisht me të gjithë informacionin relevant për OSHC-të (data e regjistrimit, detaje për adresat/kontaktin, sektorin(t) e aktiviteteve, emri i presidentit/personave të tjerë të autorizuar për të përfaqësuar OSHC-në, etj.) dhe të kërkueshme sipas kriterëve të ndryshme (emër, grup/ nëngrup i aktiviteteve, qyteti/rajoni i selisë së OSHC-së, etj.)

Statusi: e pazbatuar

Nuk është ngritur asnjë lloj baze të dhënash.

7.3. ndryshimi i legjislacionit aktual ose hartimi i legjislacionit të ri që rregullon raportimin financiar të OJF-ve, me qëllim që të përgatiten modele të reja raportimi që mundësojnë përgatitjen e statistikave më të avancuara për OSHC-të.

Statusi: e pazbatuar.

Nuk është bërë asnjë ndryshim ligjor.

7.4. publikimi i skedave të përditësuara me statistika kyçe për kontributin e sektorit të shoqërisë civile në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit, si dhe përhapja e gjerë e rezultateve

Statusi: e pazbatuar.

Nuk është publikuar asnjë lloj skede statistikore.

8. ZHVILLIMI I VULLNEARIZIMIT

Ligji i vullnetarizmit nuk është konsultuar gjerësisht me sektorin e OSHC-ve dhe mbetet joefikas. Nuk ka ende akte nënligjore për zbatimin e tij.

Masat e propozuara:

8.1. miratimi i Ligjit për Vullnetarizmin që rregullon qartë mundësitë, të drejtat dhe detyrimet në lidhje me punën vullnetare.

Statusi: e pazbatuar

Ligji i sapomiratur nuk e rregullon qartë sektorin. Nuk ka një sistem për regjistrimin e vullnetarëve. Kërkesat për sigurime nxjerrin një pengesë të madhe për të gjitha aktivitetet e vullnetarizmit.

8.2. mbështetja e forcimit të qendrave vullnetare vendore në Shqipëri, si infrastrukturë e nevojshme për punën vullnetare.

Statusi: e pazbatuar

K është ngritur asnjë qendër vullnetarësh.

8.3. ngritja e skemave të financimit nga Shteti për të mbështetur zhvillimin dhe menaxhimin e programeve vullnetare, si në OSHC ashtu edhe në institucionet publike në mbarë vendin

Statusi: e pazbatuar

Nuk është ngritur asnjë skemë financimi.

8.4. krijimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi shpeshtësinë dhe përhapjen e veprimtarive vullnetare (mundësisht përmes akteve nënligjore specifike që përcaktojnë kriteret e raportimit për organizatorët e punës vullnetare), si edhe vlerën ekonomike të punës vullnetare

Statusi: e pazbatuar

Nuk është krijuar asnjë instrument.

8.5. krijimi i Çmimit Kombëtar për punën vullnetare si pjesë e promovimit të praktikave më të mira në vullnetarizëm si edhe inkurajimi i interesit mediatik për këtë çështje

Statusi: e pazbatuar

Nuk është krijuar asnjë çmim.

9. KONTRIBUTI I OSHC-ve NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN TË SHQIPËRISË

Shumë pak progres, pasi nuk ka një strategji negociimi dhe KKIE është pasive që prej fillimit të vitit 2017. Nuk dihet qartë nëse do të riaktivizohet dhe, nëse po, kur.

Masat e propozuara

9.1. mundësimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në të gjitha grupet e ekspertëve, grupet e punës për çdo kapitull dhe takimet e ekipit negociator kurdo që çështjet e aderimit prekin shoqërinë civile, përmes një procesi përzgjedhjeje transparent pas një ftese publike me kritere të qarta

Statusi: e pazbatuar.

Nuk është ngritur një grup kryesor negociimi.

9.2. angazhimi i OSHC-ve në kryerjen e vlerësimeve të ndikimit rregullator, kur përgatiten pozicionet kombëtare negociuese dhe bëhet harmonizim ligjor, me qëllim që të bëhet identifikimi i risqeve në kohën e duhur

Statusi: e pazbatuar

Nuk është përgatitur asnjë pozicion negociues.

- 9.3. Kontributi për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve për një monitorim efikas të zbatimit të acqui të BE-së dhe qëndrueshmërisë së reformave për anëtarësimin në BE

Statusi: nuk ka informacion.

OSHC-të nuk kanë akses në të dhëna të konsoliduara për reformat për anëtarësimin në BE dhe për rolin e OSHC-ve në këtë proces.

- 9.4. mbështetja e ngritjes së fondit për bashkëfinancimin e projekteve të BE-së për OSHC-të.

Statusi: e pazbatuar

Nuk është ngritur asnjë fond bashkëfinancimi.

- 9.5. përgatitja e strategjisë së komunikimit publik për procesin e integritimit në BE, ku specifikohet roli i shoqërisë civile në zbatimin e strategjisë.

Statusi: e pazbatuar

Nuk është përgatitur asnjë strategji komunikimi.

- 9.6. investimi i fondeve shtesë në forcimin e rrjeteve evropiane të OSHC-ve që të forcojnë kapacitetet për pjesëmarrjen e tyre në proceset e politikave kombëtare, edhe që të mundësohen për të dhënë kontribut më thelbësor në promovimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe solidaritetit ndërmjet qytetarë shqiptarë dhe qytetarëve të BE-së

Statusi: e pazbatuar.

Nuk është investuar asnjë fond për forcimin e rrjeteve evropiane për OSHC-të në Shqipëri.

- 9.7. forcimi i kapaciteteve të Njesisë për Shoqërinë Civile dhe Strategjinë pranë MIE-s që të luajë rol kyç në sigurimin e përfshirjes aktive të OSHC-ve në të gjitha aspektet e procesit të integritimit evropian të Shqipërisë

Statusi: e pazbatuar

Është ngritur njësia.

- 9.8. Mundësimi i përfshirjes efikase të OSHC-ve në punën e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian (në bazë të kriterëve transparente të përzgjedhjes), si mekanizmi institucional kyç i konsultimit për çështje të BE-së.

Statusi: në proces zbatimi

Disa janë përfshirë në KKIE, por Këshilli nuk është mbledhur që prej shkurtit 2017.

Shtojca 1 Statusi i masave të vitit 2015 sipas vëzhgimeve të anëtarëve të OSHC-ve në Këshill

Fushat prioritare në Udhërrëfyesin e 2015-ës		Masat e vendosura në Udhërrëfyesin e 2015-s	E zbatuar	E pazbatuar	Në proces zbatimi	Nuk ka informacion
1.1	1	Përgatitja e Strategjisë Kombëtare për krijimin e mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri deri në 2020		x		
1.2.	2	Mundësimi i pjesëmarrjes së OSHC-ve në të gjitha fazat e përgatitjes së Strategjisë dhe Planit të Veprimit		X		
1.3	3	Përgatitja e raportit mbi rezultatet e konsultimeve publike për draftin e Strategjisë/Planit Kombëtar		X		
1.4	4	Ngritja e një sistemi të hapur dhe transparent për gjurmimin e progresit të bërë në zbatimin e të gjitha masave		X		
1.5	5	Kryerja e vlerësimit të jashtëm të zbatimit të Planit të Veprimit.		X		
2.1	6	Miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave për ngritjen e Këshillit Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile	X			
2.2	7	Organizimi i procesit të përzgjedhjes transparente të anëtarëve të OSHC-ve në Këshill	X			
2.3	8	Sigurimi i mbështetje efikase administrative dhe profesionale për Këshillin			X	
2.4	9	Përgatitja e një strategjie afatgjatë për AMSHC-në për arritjen e objektivave kryesorë të parashikuar në statutin e saj			X	
2.5	10	Hartimi i planit të komunikimit, informimit dhe angazhimit që t'i përgjigjet kërkesave në rritje për informim dhe mbështetje nga OSHC-të vendore		X		
2.6	11	Organizimi i asistencës teknike të BE-së për AMSHC-në që të ndërtojë kapacitetet për menaxhimin e fondeve të BE-së për shoqërinë civile në të ardhmen				X
2.7	12	Ndryshimi i strukturës organizative të Kryeministrit për të mundësuar ngritjen e një Njësie për koordinimin e politikave të shoqërisë civile brenda Departamentit të Zhvillimit të Programimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj		X		
2.8	13	Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për funksionimin efikas të njësive		X		
2.9	14	Emërimi i personave të kontaktit dhe, aty ku është e nevojshme, ngritja e njësive të posaçme për bashkëpunim me OSHC-të në ministri dhe organe të tjera qeveritare		X		

Fushat prioritare në Udhërrëfyesin e 2015-ës		Masat e vendosura në Udhërrëfyesin e 2015-s	E zbatuar	E pazbatuar	Në proces zbatimi	Nuk ka informacion
2.10	15	Publikimi i listës së personave të kontaktit me të dhënat e nevojshme në faqen zyrtare të të gjitha ministrive/organeve publike	X			
2.11	16	Organizimi i takimeve sistematike koordinuese me personat e kontaktit		X		
3.1.	17	Miratimi i akteve të nevojshme nënligjore dhe sigurimi i parakushteve të nevojshme institucionale që garantojnë zbatimin efikas të ligjit për njoftimet dhe konsultimet		X		
3.2.	18	Krijimi i regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike		X		
3.3.	19	Përgatitja e manualit me udhëzime të detajuara hap pas hapi për nëpunësit civilë për kryerjen e konsultimeve publike efikase		X		
3.4.	20	Përgatitja e metodologjisë për raportimin vjetor të rezultateve të konsultimeve publike dhe transparencës së proceseve vendimmarrëse me informacionet e nevojshme për numrin e akteve të miratuara nga organet publike gjatë një viti të caktuar		X		
3.5	21	Dhënia e një çmimi të përvitshëm kombëtar për praktikantët më të mira sa i përket transparencës dhe gjithëpërfshirjes së procesit vendimmarrës në organet publike		X		
3.6	22	Krijimi i një programi trajnues për nëpunësit civil, i drejtuar nga Shkolla Shqiptare për Administratën Publike, fokusuar në bashkëpunimin Qeveri-shoqëri civilë në politikë-bërjen publike			X	
4.1	23	Ndryshimi i ligjit për organizatat jofitimprurëse me nene të reja për mbështetjen shtetërore të OJF-ve, që siguron bazën ligjore për miratimin e akteve nënligjore (rregullore), për përcaktimin e standardeve, parametrevave dhe kriterëve të qarta për alokimin e fondeve publike për programet e OSHC-ve, përfshi kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve sociale si në nivel kombëtar dhe vendor të qeverisjes.		X		
4.2	24	Krijimi i një databaze publike me informacion të detajuar rreth të gjitha granteve nga buxheti i Shtetit për OSHC-të, ku organizatat dhe ministritë/institucionet publike mund të gjejnë informacion.		X		
4.3	25	Përgatitja e raporteve vjetore për financimin e përgjithshëm publik për programet e OSHC-ve me analizë të detajuar të fushave kryesore dhe të përfituesve të granteve, si dhe të dhëna të sakta mbi punën e të gjitha organeve publike që ofrojnë financim për programet e OSHC-ve, në drejtim të respektimit të		X		

Fushat prioritare në Udhërrëfyesin e 2015-ës		Masat e vendosura në Udhërrëfyesin e 2015-s	E zbatuar	E pazbatuar	Në proces zbatimi	Nuk ka informacion
		standardeve, parimeve dhe procedurave të vendosura nga Rregullorja.				
4.4	26	Përgatitja e raporteve vjetore për financimin e përgjithshëm publik për programet e OSHC-ve me analizë të detajuar të fushave kryesore dhe të përfituesve të granteve, si dhe të dhëna të sakta mbi punën e të gjitha organeve publike që ofrojnë financim për programet e OSHC-ve, në drejtim të respektimit të standardeve, parimeve dhe procedurave të vendosura nga Rregullorja		X		
4.5	27	Amendimi ose miratimi i akteve të reja ligjore në fushën e prokurimit publik, standardizimit dhe licencimit të shërbimeve sociale, në mënyrë që të mundësojë kontraktimin efektiv të OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve sociale		x		
5.1	28	Ndryshimi i ligjit aktual për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse për të mundësuar decentralizimin e procesit të regjistrimit të OJF-ve		X		
5.2	29	Përgatitja e udhëzimeve të hollësishme për organet kompetente të regjistrimit në nivel vendor për të siguruar zbatimin e harmonizuar të ligjit		X		
5.3.	30	Hartimi i programit trajnues për organet kompetente (gjykatat) për regjistrimin e OJF-ve		X		
5.4	31	Krijimi i një sistemi të përbashkët elektronik informacioni që lidh të gjitha organet e regjistrimit në nivel lokal dhe që lejon përditësimin automatik të informacionit për të gjitha OJF-të e regjistruara		X		
6.1	32	Hartimi i një projekt-akti të veçantë për operacionet financiare dhe kontabilitetin e OJF-ve që merr parasysh specifikat e menaxhimit të tyre	X			
6.2	33	Hapja e debatit publik për rishikimin e modeleve të raportimit financiar për OJF-të për të mundësuar mbledhjen/grumbullimin e të dhënave cilësore për sektorin jofitimprurës			X	
6.3.	34	Ndryshimi i legjislacionit aktual tatimor për t'u dhënë mundësi të gjithë individëve për t'ua njohur si të zbritshme donacionet që u bëjnë OSHC-ve për të nxitur filantropinë individuale dhe për të kontribuar në qëndrueshmërinë e përpjekjeve për zhvillimin e shoqërisë civile		x		
6.4	35	Analizimi i impaktit të kërkesës aktuale ligjore që e detyron çdo OSHC të regjistruar që të ketë të paktën një punonjës për të cilin është paguar sigurimi shëndetësor dhe social.			X	
6.5	36	Krijimi i një baze qendrore të dhënash online që		X		

Fushat prioritare në Udhërrëfyesin e 2015-ës		Masat e vendosura në Udhërrëfyesin e 2015-s	E zbatuar	E pazbatuar	Në proces zbatimi	Nuk ka informacion
		përmban të gjitha raportet financiare të organizatave jofitimprurëse që mund të bëhen publike me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së OJF-ve				
7.1	37	Ndryshimi i ligjit për organizatat jofitimprurëse me nene të reja për mbështetjen shtetërore të OJF-ve, që siguron bazën ligjore për miratimin e akteve nënligjore (rregullore), për përcaktimin e standardeve, parametrave dhe kritereve të qarta për alokimin e fondeve publike për programet e OSHC-ve, përfshi kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve sociale si në nivel kombëtar dhe vendor të qeverisjes		X		
7.2	38	Krijimi i një databazë të aksesueshme publike për të lejuar publikun e interesuar që të ketë akses në të dhënat themelore të OSHC-ve të regjistruara, që do të përditësohet rregullisht me të gjithë informacionin relevant për OSHC-të (data e regjistrimit, detaje për adresat/kontaktin, sektorin(t) e aktiviteteve, emri i presidentit/ personave të tjerë të autorizuar për të përfaqësuar OSHC-në, etj.) dhe të kërkueshme sipas kritereve të ndryshme (emër, grup/ nëngrup i aktiviteteve, qyteti/rajoni i selisë së OSHC-së, etj.)		X		
7.3	39	Ndryshimi i legjislacionit aktual ose hartimi i legjislacionit të ri që rregullon raportimin financiar të OJF-ve, me qëllim që të përgatiten modele të reja raportimi që mundësojnë përgatitjen e statistikave më të avancuara për OSHC-të		X		
7.4	40	Publikimi i skedave faktike të përditësuara e statistika kyçe për kontributin e sektorit të shoqërisë civile në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit dhe shpërndarja gjerësisht e rezultateve		x		
8.1	41	Miratimi i Ligjit për Vullnetarizmin që rregullon qartë mundësitë, të drejtat dhe detyrimet në lidhje me punën vullnetare dhe i akteve nënligjore		X		
8.2.	42	Mbështetja e forcimit të qendrave vullnetare vendore në Shqipëri, si infrastrukturë e nevojshme për punën vullnetare		x		
8.3	43	Ngritja e skemave të financimit nga Shteti për të mbështetur zhvillimin dhe menaxhimin e programeve vullnetare, si në OSHC ashtu edhe në institucionet publike në mbarë vendin		x		
8.4	44	Krijimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave për shpeshësinë dhe shtrirjen e aktiviteteve vullnetare (mundësisht përmes akteve të posaçme nënligjore që do të përkufizonin kriteret e raportimit për organizuesit e punës vullnetare), si dhe të vlerës ekonomike të punës vullnetare		X		

Fushat prioritare në Udhërrëfyesin e 2015-ës		Masat e vendosura në Udhërrëfyesin e 2015-s	E zbatuar	E pazbatuar	Në proces zbatimi	Nuk ka informacion
8.5	45	Krijimi i Çmimit Kombëtar për punën vullnetare si pjesë e promovimit të praktikave më të mira në vullnetarizëm si edhe inkurajimi i interesit mediatik për këtë çështje		X		
9.1	46	Mundësimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në të gjitha grupet e ekspertëve, grupet e punës për çdo kapitull dhe takimet e ekipit negociator kurdo që çështjet e aderimit prekin shoqërinë civile, përmes një procesi përzgjedhjeje transparent pas një ftese publike me kritere të qarta		X		
9.2	47	A i OSHC-ve në kryerjen e vlerësimeve të ndikimit rregullator, kur përgatiten pozicionet kombëtare negociuese dhe bëhet harmonizim ligjor, me qëllim që të bëhet identifikimi i risqeve në kohën e duhur		X		
9.3	48	Sigurimi i fondeve adekuate nga BE-ja për zhvillimin e shoqërisë civile, sidomos për programet që kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve që të kryejnë monitorim efektiv të zbatimit të acquis të BE-së dhe kohëzgjatjes së reformave të integritit evropian				X
9.4	49	Mbështetja e ngritjes së fondit për bashkëfinancimin e projekteve të BE-së për OSHC-të		X		
9.5	50	Përgatitja e Planit të Komunikimit publik për procesin e integritit në BE, ku specifikohet roli i shoqërisë civile në zbatimin e planit të komunikimit		X		
9.6	51	Investimi i fondeve shtesë në forcimin e rrjeteve evropiane të OSHC-ve që të forcojnë kapacitetet për pjesëmarrjen e tyre në proceset e politikave kombëtare, edhe që të mundësohen për të dhënë kontribut më thelbësor në promovimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe solidaritetit ndërmjet qytetarëve shqiptarë dhe qytetarëve të BE-së		X		
9.7	52	Forcimi i kapaciteteve të Njësisë për Shoqërinë Civile dhe Strategjinë pranë MIE-s që të luajë rol kyç në sigurimin e përfshirjes aktive të OSHC-ve në të gjitha aspektet e procesit të integritit evropian të Shqipërisë		x		
9.8	53	Mundësimi i përfshirjes efektive të OSHC-ve në punën			X	

Fushat prioritare në Udhërrëfyesin e 2015-ës	Masat e vendosura në Udhërrëfyesin e 2015-s	E zbatuar	E pazbatuar	Në proces zbatimi	Nuk ka informacion
	e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian (bazuar në kritere përzgjedhjeje transparente), si mekanizëm institucional kyç për konsultimet mbi çështjet e BE-së				